



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.12.2019, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi nën për nën i projektligjit "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit"

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Artur Roshi, Krenar Ryci, Korab Lita dhe Ylli Shehu.

Mungojnë:

Antoneta Dhima, Reme Lala

Të ftuar:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

1. Z. Elton Haxhi, Zv/Minister,
2. Z. Nikolla Lera, Drejtor I Përgjithshëm,
3. Znj. Delina Ibrahimaj, Drejtor I Përgjithshëm I Tatimeve

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Vazhdojmë diskutimin nen për nen.

Neni 1. Dua të më ndjekin të gjithë ata që kanë meraqe. Është rënë dakord me ndryshimin e formuluar këtu. Ta lexoj formulimin? Dakord, po e lexoj për efekt regjistrimi. Reformulohet: “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, rregullave, kritereve, detyrimeve, afateve dhe procedurave që duhet të ndiqen nga tatimpaguesi, prodhuesi dhe mirëmbajtësi i zgjidhjeve *software*, lidhur me lëshimin e faturës, faturën shoqëruese dhe faturën elektronike, përmbajtjen e faturave, regjistrimin e të dhënave dhe procedurën e fiskalizimit të lëshimit të faturave, marrjen e informacionit të pagesave, certifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji”.

(Mungesë audio)

E di, por dua që të jetë edhe tek objekti i ligjit.

Elton Haxhi - Unë do të sugjeroja që, nëse do të bëni ndonjë shtesë specifike të ndonjë komponenti, siç janë kasat fiskale, të ishte duke mos përjashtuar...

(Diskutim pa mikrofon)

Ose “përfshirë” ose “duke mos përjashtuar”. Dakord?

(Mungesë audio)

Arben Ahmetaj – Kundër? Jeni kundër objektit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull. Atëherë, kush është pro me ndryshimin që kemi hartuar dhe me ndryshimin e fundit që do të riformulohet? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1.

Vijmë te neni 2. Këtu nuk kemi ndryshime. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Ky nen riformulohet me këto ndryshime: Për qëllime të teknikës legislative, pas çdo termi që përkufizohet, sugjeroj të vendosen foljet “është” ose “janë”, “apo ka të njëjtin kuptim me atë në varësi të kontekstit të fjalisë së nevojshme”. Dakord? Germa “d” nenet 24 dhe 25 “që trajtojnë faturën elektronike me para në dorë dhe për organet publike dhe përmbajnë tërë procedurën e lëshimit dhe funksionit të saj”, sugjeroj që “referenca” te këto nene duhet hequr nga përkufizimet. Kemi rënë dakord me Ministrinë e Financave.

Te paragrafi i parë i germës “k”, kemi togfjalëshin “Sistemi fiskal është tërësia e pajisjeve fiskale dhe zgjidhjeve softuerike që mund të përfshijë dhe çdo zgjidhje softuerike të ndërmjetme që përdoret për lëshimin dhe marrjen e faturës e të faturave shoqëruese, zbatimin e procedurës së fiskalizimit dhe shkëmbimit elektronik të mesazheve, komunikimin ndërmjet tatimpaguesve që lëshojnë fatura shoqëruese dhe sistemit të teknologjisë së informacionit, të administratës tatimore qendrore duke përdorur një rrjet të sigurt të shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet lidhjes elektronike, internetit. Sistemi fiskal përdoret gjithashtu për shkëmbim elektronik të mesazheve dhe komunikimit ndërmjet bankave, institucioneve financiare jobankare dhe subjekteve të tjera që ofrojnë shërbime, pagesave të faturave elektronike dhe sistemi i teknologjisë së informacionit të administratës tatimore qendrore”.

Para se të vazhdojmë më poshtë, ju bëj thirrje për të reflektuar. Po ta quajmë “sistem fiskalizimi”, se nuk është sistem fiskal, sistemi fiskal nuk janë këto pajisjet...

Pra, ose ta quajmë “sistem fiskalizimi” ose të përdorim një togfjalësh tjetër, pasi sistem fiskalizimi u referohet instrumenteve, procedurës dhe logjistikës, ndërsa sistemi fiskal është ai që përmbledh politikat, procedurat, instrumentet dhe logjistikën. Këtu jemi duke iu referuar një logjistike me procedura dhe unë sugjeroj të jetë sistemi i fiskalizimit. Nëse do ta fusim këtë, do të fusim edhe definicionin. Pra, te definicionet e përgjithshme, mund të përdorim definicionin e fiskalizimit. Ejani ta gjykojmë si e mendoni edhe ju.

Elton Haxhi – Për ndryshimin jemi dakord, por ky është përkufizimi i sistemit të fiskalizimit.

Arben Ahmetaj – Dakord me “sistem i fiskalizimit”? Pra, ky nen është definicioni. Bini dakord me “sistem i fiskalizimit”? Zëvendësministër, Niko? Dakord. Atëherë ndryshon në “sistem i fiskalizimit”, që do të thotë se çdo gjë u ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S’kemi pse të ikim. Është ligj shumë i rëndësishëm.

(Mungesë audio)

Mund të vazhdojmë?

Meqë si proces është fiskalizim, mund ta quanim “sistem i fiskalizimit”, megjithatë, para se të bëjmë hapa para, ka ndonjë sugjerim? Atëherë, reflektoni deri në fund Delina, bashkë me Nikon dhe Tonin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, i referohet një tërësie, jo faturë. E ke lexuar nenin?

Do t'ju lutesha që të mendoheni. Pastaj vazhdojmë. “Sistemi i fiskalizimit” apo termi që do të zgjedhim së bashku përfshin: “Në germën “i”, nënpika “ii”, sugjeroj heqjen e fjalës “disa nga”, pasi nuk është term që mund të përdoret në ligj, thotë teknika ligjore.

Germa “I” sugjerohet të riformulohet për teknikë legjislative me këtë përmbajtje: “Tatimpagues është personi juridik apo fizik që ka detyrimin të lëshojë faturë, ose faturë shoqëruese sipas këtij ligji ose legjislacionit në fuqi “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Keni rënë dakord për këtë.

Atëherë, me këto ndryshime dhe me atë element që thamë, do të rishikohet deri në fund.

Kush është dakord me nenin 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Në nenin 4, për qartësi dhe teknikë legjislative sugjerojmë: germa “c” deri te germa “d” të riformulohet si vijon: germa “c”, “Të cilët janë tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore dhe vendore, organizatat politike dhe institucione të tjera të ngjashme”. Pra, edhe organizatat politike.

Germa “ç”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje nga zoti Angjeli: “Po organizatat politike pse i keni futur”?

Elton Haxhi – Nëse kam detyrimin për të lëshuar faturë sipas ligjit të TVSH-së, janë edhe këtu subjekt i ligjit, ndaj edhe ne e kemi lidhur gjithmonë me ligjin e TVSH-së.

Arben Ahmetaj – Kjo që thoni ju është e drejtë, sepse, në fushatat elektorale, në bazë të ligjit të partive politike, kanë financimet e tyre dhe mund të bëjnë aktivitete në funksion të fushatës elektorale në bazë të ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëshojnë dhe auditohen, doja të thosha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk po shet, por po bën një transaksion. Po marr një shembull: prodhon fletëpalosje, prodhon manifestin e vet politik, prodhon....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dikujt ia blen. Ata nuk po e ndajnë në shitje ose në blerje, po e konsiderojnë transaksionin.
(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë u bëjnë partive politike, më besoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Germa “ç”, “të cilët janë tatimpagues rezidentë ose jorezidentë, pavarësisht nga forma e organizimit kur furnizojnë mallra ose shërbime për organet publike, përveçse një organ publik i nënshtrohet TVSH-së dhe ka detyrim të lëshojë një faturë si marrës i mallrave ose shërbimeve”.

Germa “d”, “të cilët janë tatimpagues jorezidentë për furnizimin e mallrave se ofrimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë kur në përputhje me legjislacionin tatimor sipas përcaktimeve në germat “a”, “b”, “e” dhe “c” të këtij neni, i nënshtrohen detyrimit tatimor në Republikën e Shqipërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor”.

Unë kam një pyetje që ta sqaroni komisionin dhe mua. Një tatimpagues jorezident nuk e detyroni dot të përdorë këtë sistem. Mund të ma sqaroni ku e keni fjalën?

Zoti Niko, më sillni një shembull që ju do të detyroni një tatimpagues jorezident.

Elton Haxhi - Detyrim për tatimpaguesin jorezident për të lëshuar faturë ekziston në rastin kur lëshon një “e – ivoice”, sepse sistemi do të pranojë edhe “e-invoice” nga tatimpaguesit jorezidentë nëpërmjet platformës së Bashkimit Europeanë. Shprehja “vetë”, besoj për atë e keni pyetjen, i referohet këtij rasti, ose rastit kur hap degë.

Arben Ahmetaj – Po ai po hapi degë, është rezident, nuk është më jorezident. Ai automatikisht merr NIPT-in dhe bëhet rezident.

Më thoni një rast kur jorezidentin e detyrojmë.

Elton Haxhi – Vetëm tek “e-invoice”.

Arben Ahmetaj – Nuk e detyrojmë të përdorë formatin tonë.

Elton Haxhi – Jo, formati ynë është sipas direktivës Europiane për “e-invoice”.

Arben Ahmetaj – Jeni duke detyruar një jorezident të jetë subjekt i këtij ligji. Turistët janë konsumatorë kur vijnë këtu dhe nuk kanë nevojë, por po flas për një tatimpagues jorezident.

Elton Haxhi – Në qoftë se e zbërthen nenin në detaje ku thuhet: “Në përputhje me legjislacionin tatimor sipas përcaktimeve të këtyre shkronjave, u nënshtrohet detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Arben Ahmetaj – Pra, ai do të paguajë detyrimet tatimore atje, pala do të paguajë këtu, ai nuk paguan këtu nëse është jorezident, ai nuk faturon këtu nëse është jorezident, më falni për diturinë time të cekët në këtë drejtim, por nuk arrij ta kuptoj.

Elton Haxhi – Duhet të shohësh germat “a”, “b”, “e” dhe “c”.

Arben Ahmetaj – I pashë dhe i lexova. Më thoni si e detyrojmë tatimpaguesin jorezident që të zbatojë në vendin e tij ligjin që bëj unë dhe ti këtu? Kaq.

Mendoheni deri në fund.

Elton Haxhi – Germat “a”, “b” dhe “c” kërkojnë regjistrim në Republikën e Shqipërisë. Pra, është jorezident, por kur plotëson kushtet që duhet të hapë një *permanent establishment* në Shqipëri, atëherë është subjekt i këtij ligji. Është pak indirekte.

Arben Ahmetaj – Më falni, ditën që ai vjen dhe hap rezidencë këtu nuk është më jorezident, por rezident.

Elton Haxhi - Ky nen ka parashikuar rastin edhe kur duhet të bëhet rezident para se t'i nënshtrohet këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj - 3 minuta pushim.

Elton Haxhi – A keni ndonjë kundërshtim ta heqim? Ku janë? Ilda? Pra, përveç përfaqësuesit tatimor, fjala “vetë” pse duhet?

(Ndërprerje incizimi)

Arben Ahmetaj – “Tatimpagues jo rezident, për furnizimin e mallrave ose ofrimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, kur në përputhje me legjislacionin tatimor, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, u nënshtrohen detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor”. Pra, po të jap dy shembuj, një që dërgon mallra në Shqipëri, sepse ia ka blerë. Pra kanë blerë frigoriferë, jorezidenti ia dërgon kompanisë në Shqipëri faturën. Si ia dërgon faturën, në bazë të këtij ligji?

Elton Haxhi – Mund tja dërgoj “e-invoice”.

Arben Ahmetaj - Si të dojë, do t'ia dërgojë. Toni, po si t'ia dërgojë pra, se ai ka legjislacionin e vet?

Elton Haxhi – Nëse legjislacioni kërkon që duhet të caktoj një përfaqësues tatimor në ato rastë që e parashikon ligji i TVSH atëherë nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor lëshon faturën.

Arben Ahmetaj -Përfaqësuesi tatimor, a është rezident?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që do të thotë në ushtrim fiskal ai faturon nga brenda. Le të themi që unë jam përfaqësuesi i një kompanie në Amerikë, Amazon, për shembull. Unë jam subjekt rezident, marrëdhënien me Amazonin, unë e kam ndryshe, mua Amazon nuk më faturon dot në bazë të ligjit në Amerikë, unë do t'i bëj faturën time në bazë të ligjit vendas.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, por është rezident dhe është përfaqësues tatimor dhe e ka detyrim të ndjekë formatin e faturës që i cakton ti, marrëdhënien me Amazonin, ti nuk ia detyron dot si të faturojë këtu.

Vullnet Sinaj – Kam një pyetje, ju thatë se kjo ka të bëjë me rastet kur ligji për TVSH-në e detyron një eksportues të huaj. Bëhet fjalë vetëm për shërbime, nuk bëhet fjalë për shitje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përcaktojeni atëherë, është për në rastin e shërbimeve, sepse mund ta shfrytëzojnë edhe për produkte të tjera për shitje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Përfaqësuesi tatimor caktohet vetëm në rastet e shërbimeve dhe kur personi që merr shërbimet nuk është subjekt i TVSH. Vetëm në këto raste kërkohet përfaqësues tatimor, sepse në rastet e tjera kur shërbimi i ofrohet një tatimpaguesi të TVSH bëhet me *rivers charge*, me autongarkesë, atëherë, për ta kufizuar mund të heqim pjesën e furnizimit të mallrave, sepse nuk bëhet fjalë për furnizim mallrash, por vetëm për furnizim shërbimesh dhe të heqim fjalën “vetë”, që na ngatërron dhe ta lëmë nëpërmjet përfaqësuesit tatimor.

Arben Ahmetaj – Që shkurt do të thotë neni detyron vetëm rezidentin, përfaqësuesin. Pra, gjithë kohës erdhëm vërdallë, por prapë erdhëm te logjika e rezidentit.

Elton Haxhi - Mos na hiqni gjithë nenin se mund të hapim ndonjë gropë.

Arben Ahmetaj – Nuk po heqim gjithë nenin, por përgjegjësinë e tatimpaguesit jorezident. Ne nuk kemi ardhur me sëpatë, ne kemi ardhur të rregullojmë. Me kënaqësi e bëjmë.

Atëherë, kush është dakord me nenin 4 me këto ndryshime? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. “Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë, përjashtimisht përcaktimeve të nenit 4 të këtij ligji, nuk janë të detyruar të lëshojnë faturë për llojet e veprimtarisë dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve si më poshtë: për prodhuesit bujqësorë, që

janë subjekte të skemës së kompensimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Po të tjerët që nuk janë?

Ata që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit, nga pjesa e kompensimit përfitojnë vetëm 31 mijë, që është duke u reduktuar fatkeqësisht, po të tjerët?

Niko Lera – Të tjerët janë mbi 5 milion lek dhe janë me regjimin normal të TVSH

Arben Ahmetaj – Ose nuk janë në radarin tënd dhe janë më të vegjël. Pra, ose janë mbi 5 milionë dhe janë tek TVSH-ja, ose nuk janë në radarin tënd, janë më ulët, dhe nuk marrin kompensim, por ti nuk i përjashton. Tani do të bëj unë punonjës in tënd?

Elton Haxhi - Të njëjtin përcaktim kemi edhe aktualisht vetëm se këta janë të përjashtuar. Nuk kemi bërë asnjë ndryshim nga lëshimi i faturës ose kuponit.

Arben Ahmetaj – Pra, ti do t’i thuash fermerit, i cili nuk merr kompensim dhe kur lëshon faturë që është nën 5 milionë, që do të marrësh softin, ose kasën? Ai është 3 milionë, nuk merr kompensim, ose nuk përfiton nga skema e kompensimit, çfarë ndodh me atë?

Niko Lera – Do shes pa faturë

Arben Ahmetaj – Do të shesë pa faturë? E ke të përjashtuar? Ku e ke? Është jashtë skemës së kompensimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të bëjmë nga këto tani. U bëra pyetje përfaqësuesve të Ministrisë së Financave se çfarë ndodh me një fermer, i cili nuk merr kompensim, nuk përfiton nga skema e kompensimit të TVSH-së, është nën 3 milionë çfarë ndodh me atë? A është i përjashtuar, apo jo? Nëse është i përjashtuar, ku është i përjashtuar? Nëse nuk është i përjashtuar, përjashtohet. Dakord? Deri tani nuk kanë qenë të detyruar të marrin kasë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi - Mund ta përfitojnë kompensimin, por nuk kanë shkuar ta tërheqin, por janë subjekt. Pra, e plotësojnë kriterin, kjo është e rëndësishme. Nëse e plotësojnë kriterin....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, mund ta lidhim me xhiron.

Në rregull, po e lidhim me xhiron.

Arben Ahmetaj – Pika 2. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, tatimpaguesi nuk është i detyruar të lëshojë faturë edhe për rastet e tjera të përjashtimit nga ky detyrim sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

Kush është dakord me nenin 5, me këto specifikime që kërkoja unë të shkruhen nga shërbimet e Kuvendit dhe Ministria e Financave?

Niko, thuaje me zë që ta shijojmë edhe atë që the.

Në rregull, bëjeni mirë që të mos i shkojë pastaj Delina fermerëve dhe t'iu kërkojë faturë.

Do ta raportoj këtë çështje te zëvendëskryeministri.

Kush është pro me ndryshimet? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Media, shënojeni që fermerët janë të përjashtuar nga fiskalizimi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë fermerë ata, janë në sipërmarrje. Faleminderit për mirëkuptimin!

Kalojmë te neni 6. Në këtë nen sugjeroj dhe kam komentet e mëposhtme: Në pikën 1 për teknikë legjislativë dhe si të panevojshëm sugjeroj heqjen e përcaktimit “përveç asaj të përjashtuar, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji”.

Lidhur me pikën 7 të këtij neni, vlerësoj se kërkimi i përkthimit të faturës në gjuhën shqipe është një barrierë administrative. Kjo ndikon si në kohën që do t'i duhet tatimpaguesit për përkthimin dhe legalizimin e përkthimit te noteri, gjithashtu, është edhe kosto plus. Theksoj se në rastin e importeve dhe eksporteve, faturat janë në gjuhë të huaj dhe janë me qindra në ditë, në të gjithë Shqipërinë. Jo me qindra, me mijëra. Ke hequr tri zero. Sugjeroj se ky kusht, megjithëse është përcaktuar si një e drejtë e administratës tatimore dhe jo një detyrim për tatimpaguesit, duhet të kufizohet vetëm në ato raste kur leximi dhe kuptimi i saj është tërësisht i pamundur dhe prej këtij leximi varet vërtet fiskalizimi.

Çfarë mendimi keni, zoti, zëvendësministër?

Elton Haxhi - Ne e kemi lënë “mund” pra në rastet kur administrata tatimore e gjykon të nevojshme një përkthim.

Arben Ahmetaj– Atëherë të lexojmë nenin si e keni. Neni 6, pika 7. Na kthyet 15 vjet përpara. “Në rastet kur faturat për furnizimet e marra janë të hartuar në gjuhë të huaj, administrata tatimore për qëllime të kontrollit tatimor mund të kërkojë përkthimin autentik të faturave në gjuhën shqipe”.

A mund t'ju bëj një pyetje, drejtoreshë: Kujt ia keni kërkuar deri sot përkthimin në doganë dhe në tatime?

Delina Ibrahim - Duhet të interesohem, nuk e kam këtë informacion.

Arben Ahmetaj- Po, Niko.

Niko Lera - Kompanitë shqiptare paraqesin në mënyrë të vazhdueshme në kuadër të eliminimit të tatimeve të dyfishta dokumentacionin për të gjitha pagesat që bëjnë për furnitura të huaja dhe kërkohet që kontrata fatura dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruet të jetë edhe në gjuhën shqipe.

Arben Ahmetaj – Pra, sapo thatë thelbin për sqarim dhe deklarim final kur mbyllet dosja e përjashtimit në bazë të traktatit të marrëveshjeve për heqjen e tatimit të dyfishtë. Lëreni atje, ç’punë keni këtu? Jo, faleminderit!

Unë sugjeroj. Më falni, në Shqipëri importojnë. Ç’është kjo histori? Dakord për mbylljen e dosjes së përputhjes së materialeve, dokumenteve dhe faturave për tatimin e dyfishtë, po jo për këtë. Kjo bie.

Po, zonjë, mund të na sqaroni nëse ka ndonjë gjë shtesë! Jo. Dakord.

Faleminderit!

Kjo bie, pika 7.

Kush është pro me këto ndryshime dhe heqjen e pikës 7 të nenit 6? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Kalojmë te neni 7. Në nenin 7 të projektligjit konstatoj në pikën 2...

Çfarë keni, zoti zëvendësministër? Ndajeni shqetësimin me ne.

Elton Haxhi - Nuk janë vetëm shërbimet që janë subjekt i tatimit të dyfishtë, janë edhe mallrat. Po nëse fatura e furnitorit të huaj është në arabisht, nuk na duhet ne përkthimi?

Arben Ahmetaj – Pra, detyrimi për përkthim është brenda një pjese tjetër të legjislacionit, që ka të bëjë me tatimin e dyfishtë, nuk ka nevojë të bëhet standard për të gjitha faturat. Ky është qëndrimi i komisionit. Me të drejtë anëtarët e komisionit, nga të dyja anët, e kanë theksuar se është barrierë administrative. Nuk mund edhe me “mund” që t’i tekton një punonjësi të thotë më përkthe ti mua faturën, se mua nuk më pëlqen modeli yt i flokëve, sepse e bëjnë. Jo, ky nuk është standard. Standardi është i detyrueshëm kur mbyllet dosja e tatimit të dyfishtë, pra kur bie në regjimin e marrëveshjes për eliminimin e taksimit të dyfishtë, por jo standard fiskal.

Kalojmë te neni 7. Konstatoj se në pikën 2, shkronja “b”, një shtetas i huaj nuk detyrohet dot të përdorë standardin shqiptar në një faturë sporadike që ai lëshon. Çdo vend ka sistemin e vet të mirëpërcaktuar të faturimit dhe duket që kjo dispozitë do të ketë vështirësi ose pamundësi për t’u implementuar.

Lexojmë nenin 7, ku thuhet: “Tatimpaguesit që lëshojnë fatura janë të detyruar të lëshojnë faturë edhe për çdo pagesë të bërë përpara kryerjes së furnizimit të mallrave.....përveç detyrimit të lëshimit të faturave për çdo furnizimi të mallrave ose ofrimit...”

Kalojmë te pika 2/b: “Në kuadër të veprimtarisë ekonomike të tyre blejnë shërbime, të furnizuara nga një person i tatueshëm, që nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç, nëse ky person i tatueshëm, shitësi nga jashtë lëshon një faturë elektronike në përputhje me specifikimet teknike të përfshira në standardet shqiptare, siç janë publikuar nga institucionet përgjegjëse për standardizimin, që shkëmbehen nëpërmjet platformës qendrore të faturave në përputhje me nenin 26 të këtij ligji”.

Pra, që unë të jem i qartë dhe komisioni të jetë i qartë, ju po detyroni tatimpaguesin në Itali? Shqiptari kur lëshon faturë, është i detyruar, nuk keni nevojë ta shkruani këtu e keni standardin. Ju jeni duke folur për një nga jashtë.

Niko, si është? Ma lexo nenin!

Ju lutem, sqarojeni!

Elton Haxhi – Bëhet fjalë për autongarkesë në rastet kur blen, jo kur shet. Përveç detyrimit që ke për të lëshuar faturë kur shet, ke edhe detyrimin për të lëshuar faturë si blerës, kur blen, kjo duhet përcaktuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, kur bën autongarkesën...

Arben Ahmetaj – Si rezident?

Elton Haxhi – Po, për rezidentët jam duke folur. Përveç detyrimit të lëshimit të faturave për çdo furnizim të mallrave ose shërbimeve...

Arben Ahmetaj – E kuptova.

A mund t’ju bëj një pyetje? Çfarë do të thotë, sipas kuptimit tuaj, që nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë?

Elton Haxhi – Kur blen shërbime nga një furnitor i huaj, i cili nuk të ka dhënë as *e-invoice*, sepse e përjashton rastin e *e-invoice*, kur vjen *e-invoice* nuk ke nevojë të bësh autofaturim, sepse vjen nëpërmjet platformës dhe regjistrohet në platformë. Në rastin kur i huaji nuk të ka dërguar *e-invoice* ti je i detyruar të lëshosh një autongarkesë, autofaturë...

Arben Ahmetaj – Ju i shtoni një procedurë tatimpaguesit...

Elton Haxhi – E kemi me letër po ia japim edhe elektronikisht...

Arben Ahmetaj – Pra, bëhet fjalë vetëm për atë që lëshon autofaturë në Republikën e Shqipërisë?

Elton Haxhi – Po.

Arben Ahmetaj – Patjetër që kjo vlen, por ata duan ta thonë. Ndonjëherë kur këmbëngulin për gjëra që nuk janë aq të rëndësishme për sistemin, për ne, por për ata është, mirë është t'i lëmë.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8.

A duhet ta përmirësojmë teknikën legjislative këtu? Mendoj se nuk ka nevojë.

Kalojmë te votimi.

Kush është pro nenit 8? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Dua t'ju bëj një njoftim. Për shkak të një angazhimi që unë kam mbledhjen do ta vazhdojmë deri në orën 17:40 dhe pjesën tjetër do ta vazhdojmë nesër në orën 10:00 dhe më pas do të vazhdojmë me paketën, do të mundohemi pak...

(Diskutohet pa mikrofon)

Paradite edhe pasdite nëse do të na duhet, po nëse jemi racionalë do ta kalojmë. Nëse do të ketë debate dhe diskutime të gjata do ta shtyjmë për një seancë pasdite. Të kapim sa të kapim kohë dhe punë në këto minuta.

Neni 9.

Sa i takon pikës 1 të këtij neni, por edhe gjatë gjithë projektligjit kudo ku pas përdorimit të një termi është vendosur referenca ligjore e tij në nenin 3, fjala “përkufizimet” sugjeroj të hiqet, pasi është e nevojshme dhe thjesht konfuzion në leximin e saj.

Sa i takon germës “m” konstatoj që projektligji si te përkufizimet, ashtu edhe në brendësinë e tij nuk jep informacion se çfarë është Kodi QR. Sugjeroj që kjo të shtohet te përkufizimet që të mos ketë konfuzohet e gjithë Republika e Shqipërisë dhe më pas të fillojnë të mendojnë se çfarë është Q-ja dhe R-ja.

Konstatoj se në listën e gjatë të të dhënave që duhet të përmbajë fatura mungon evidentimi në faturë i shkallës së aplikuar të TVSh-së, element ky shumë i rëndësishëm. E kemi kërkesë e

ligjit, jam duke folur për 20%-n apo 6%-i ose 0, i cili në fakt është te ligji i TVSH-së dhe te të dhënat e faturës ndërmjet këtij ligji dhe atij të TVSH-së...

(Diskutime pa mikrofon)

Ervin, nesër mund ta drejtosh ti mbledhjen dhe do ta kuptosh se sa lodhesh?

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk e kam problemin që ti flet, por e kam që ti provokon të folurën.

...dhe të dhënat e faturës ndërmjet këtij ligji dhe atij të TVSH-së janë konceptuar si komplementare të njëra-tjetrës. Unë mendoj se duhet të vihen edhe këtu për të unifikuar përmbajtjen e faturës, Niko. Çfarë detyrimi është te TVSH-ja të jetë edhe këtu, sepse po e ktheni në një institucion të faturës elektronike, apo nuk është kështu?

Në pikën 8, për teknikë legjislative, sugjeroj që fjalë e fundit të hiqet dhe të bashkohet me pikën 11 të këtij neni me qëllim që e drejta e Ministrisë së Financave për të nxjerrë aktet nënligjore të jetë një pikë dhe jo e shpërndarë gjithandej.

Pika 11, për arsyet e sqaruara në pikën 8, sugjeroj të riformulohet me këtë përmbajtje: “Ministri përgjegjës për Financat me udhëzim përcakton mënyrën e gjenerimit, gjatësinë dhe llojin e të dhënave për NIVF-të dhe NSLF-të dhe mund të përcaktojë kërkesa të tjera, që duhet të përmbajë një faturë për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive të zhvilluara të sendeve të tregtueshme të punimeve apo të shërbimeve”.

Kush është pro nenit 9 që këto ndryshime dhe sugjerime të kthehen në vendimmarrje? Kundër? Abstenim?

Elira, nëse keni ndonjë gjë mund të ndërhyni.

A keni ndonjë gjë teknike?

(Diskutime pa mikrofon)

Tani po kalojmë përtej të qenit pro dhe kundër. Ky është një ligj, i cili do të influencojë territorin ekonomik dhe nëse keni ndonjë gjë të qenësishme është mirë ta themi nen për nen, ta diskutojmë, gjykojmë dhe ta vendosim.

Elira a ke ndonjë gjë? Jo.

Nenin 9 u votua.

Sa i takon nenit 10 nuk ka ndryshime. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Konstatohet që në pikën 2 të këtij neni, ku përcaktohet që rregullat e renditjes numerike të numrit të faturës duhet të përshkruhen nga tatimpaguesi që lëshon faturën në një akt të brendshëm, në vlerësimin tim është i vështirë apo i pamundur për t'u zbatuar, duke njohur gamën e madhe të tatimpaguesve në të gjithë vendin dhe mënyrën e konceptimit prej tyre të të bërit biznes. Pra, jeni duke i detyruar tatimpaguesit për renditjen numerike.

Unë e kam këtë merak, por nuk e di se çfarë mendojnë anëtarët e komisionit?

(Diskutime pa mikrofon)

Përderisa të detyron në nen ne nuk duhet ta marrim me mend asnjë gjë nëse e bën apo nuk e bën fiskalizimi...

(Diskutime pa mikrofon)

Përderisa po bëjmë një sistem kompjuterik besoj që numerizimi duhet të ishte automatik, por ju e detyroni tatimpaguesin.

Toni, të lutem ma sqaro pak!

Elton Haxhi – Tatimpaguesi mund të ketë rregullat e tij të numrit serial për qëllimet e veta të brendshme, kështu që mund të përcaktojë një rregullore të brendshme se si i do këto numra. E rëndësishme është që renditja të jetë e tillë, e pandërprerë, prandaj nuk e kemi kufizuar dhe e kemi lënë të hapur...

Arben Ahmetaj – Për mua, nuk e di se çfarë mendon komisioni, mjafton të vendosni kushtin që të jetë i vazhdueshëm dhe pjesa tjetër nuk besoj që është e rëndësishme për t'u përfshirë në ligj. Çfarë mendoni ju?

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet, çfarë thatë?

(Diskutime pa mikrofon)

Po, do të jetë i vazhdueshëm.

Çfarë mendoni Niko dhe Toni?

Elton Haxhi – Problemin e kemi me fjalinë e fundit...

Arben Ahmetaj – Unë e kam me mënyrën se si e detyroni ju, por mendoj se standardin mund ta vendosni ta vazhdueshmëria...

(Diskutime pa mikrofon)

Me këtë sugjerim për ndryshim të rakordoni me shërbimin, Niko...

(Diskutime pa mikrofon)

Jo, mos ta heqim si detyrim, por të themi vetëm standardin...

(Diskutime pa mikrofon)

Çfarë mendojnë përfaqësuesit e Ministrisë së Financave?

Elton Haxhi – Ne mendojmë që ky nen nuk sjell ndonjë komplikim për tatimpaguesit, sepse gjithsesi numrin do ta gjenerojë *software* fiskal.

Arben Ahmetaj – Dakord, mjaftonte të ishte i vazhdueshëm, por nëse ju mendoni që duhet për administrim jemi në rregull.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 12.

Neni 13. Sa i takon këtij neni duket sikur ka tiparet e një dispozite tranzitore, megjithatë ju do të na e sqaroni. Në pikat 1, 2 dhe 3 të projektligjit është prezumuar që ky projektligj do të hyjë në fuqi më 1 janar 2020, por, në fakt, duke analizuar kohën e sjelljes së ligjit dhe shqyrtimin e tij në komision dhe në Kuvend, si dhe afatet kushtetuese të detyrueshme për hyrjen në fuqi të ligjit, praktikisht ky ligj nuk mund të hyjë në fuqi më 1 janar. Për këtë arsye data 31.12.2019 apo 01.01.2020, pikat 2 dhe 4 nuk mund të përdoren, pasi në këtë mënyrë i jep ligjit fuqi prapavepruese. Le të themi për një moment që nuk botohet në kohë, nuk e dekreton Presidenti në datën 19, por e dekreton në datën 29. Ky ligj kërkon kohën e tij për të hyrë në fuqi. Unë mendoj që të mos thuhet kështu, por të thuhet vetëm data e hyrjes në fuqi.

Jeni dakord?

Faleminderit!

Ju lutem, mos na lodhni kur bini dakord!

Neni 13. Kush është pro me këtë ndryshim? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 i projektligjit. Konstatohet se në pikën 5, për teknikë legjislativë, sugjerohet që fjalët “për ndryshimet domethënëse” të zëvendësohet me fjalët “lidhur me”.

Faleminderit që jeni dakord!

Vullnet Sinaj – Neni 14, pika 2...

Arben Ahmetaj – Nuk kemi ardhur akoma aty. Më falni, ku kërkoj ndjesë, mund të vazhdoni!

Vullnet Sinaj – Neni 14, pika 2, germa “dh” që ka të bëjë: “Për qëllim të zbatimit të procedurës të fiskalizimit, të lëshimit të faturave, regjistrimi sipas pikës 1 të këtij neni duhet të përmbajë së paku të dhënat e mëposhtme”. Më pas kalohet te germa “dh”: “Orarin ditor të punës, ditët e punës gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare”. A mund të ma shpjegoni pak këtë? Po kur bizneset punojnë jashtë orarit të punës? Çfarë duhet të mbajë, orarin ditor të punës, ditët gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare?

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo duhet të jetë e shkruar në faturë?

(Diskutime pa mikrofon)

Elton Haxhi – Bëhet fjalë për regjistrimin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Në momentin kur ti regjistron një pajisje fiskale të re në një pikë shitje je i detyruar t’i japësh këto të dhëna dhe një prej këtyre të dhënave është orari i punës i asaj pike shitjeje që ke.

Niko Lera – Administrata duhet ta dijë që punon 7 ditë në javë, 12 orë në ditë...

Elton Haxhi – Në një rast të veçantë do të ketë një indikator risku.

(Diskutime pa mikrofon)

Nuk është se të ndalohet ta ushtrosh veprimtarinë jashtë orarit të punës, por për sistemin e monitorimit të riskut do të ketë një indikator që do të thotë që ky biznes po lëshon fatura jashtë orarit që ka deklaruar...

Delina Ibrahim – Do të ketë vetëm kritere risku.

Vullnet Sinaj – Te pika 2 thuhet: “Për qëllim të zbatimit të procedurave të fiskalizimit e të lëshimit të faturave. Regjistrimi, sipas pikës 1 të këtij neni duhet të përmbajë së paku të dhënat e mëposhtme...” E ka fjalën për faturën që duhet t’i përmbajë të dhënat e orës?

(Diskutime pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Hedhim në votim nenin 14 me ndryshimet e propozuara. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Sa i takon nenit 15 nuk kemi asnjë ndryshim të propozuar. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

(Diskutime pa mikrofon)

Vullnet Sinaj – Sa i takon nenit 14, pika 5 e tij, në të cilin thuhet: “Nëse ndryshohet të dhënat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit,

tatimpaguesi që lëshon faturën detyrohet të paraqesë informacion për ndryshimin, të dhënat e reja në mënyrë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni ose në raste të veçanta në përputhje me pikën 4 të këtij neni jo më shumë se 24 orë pas vendndodhjes së ndryshimit”. A mund ta zgjasim këtë se 24-orëshi është shumë pak, ta bëjmë 72, 3 ditë, sepse mund të qëllojë e premtë, e shtunë ose e diel.

Arben Ahmetaj – Sa e kërkon afatin, zoti Vullnet?

Vullnet Sinaj – 72 orë.

Arben Ahmetaj – Si mendojnë anëtarët e komisionit? Unë mendoj se 72 orë është një kërkesë normale.

Hedhim në votim nenin 14 me ndryshimin që propozon Vullneti dhe ndryshimin tim për fjalët “teknikë legislative”. U shtuan 48 orë në mos gaboj apo jo?

Mendoj se kjo nuk është fare problem për administratën, pasi sot kemi raste kur nuk na njoftojnë fare për rezidencën, apo jo drejtoreshë? Mos vini gjoba të rënda për këtë!

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 15. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16. Sa i takon këtij neni konstatoj që në pikën 3 të hiqet referenca “për përkufizimet”, sepse sqarimi i plotë është bërë në pikën 9. Gjithashtu, në këtë pikë të vlerësohet që duhet pasur kujdes mbrojtja e së drejtës së autorit, IPR-ja. Në pikën 9 të nenit 16 fjalët “për funksionalitetin” të zëvendësohen me fjalët “për funksionimin”.

Pika 10 për teknikë legislative, si dhe shmangien e çdo vakuumi ligjor në këtë proces sugjeroj të riformulohet me këtë përmbajtje: “10. Me vendim të Këshillit të Ministrave përcaktohen detyrimet ligjore, kushtet dhe procedurat që ndiqen për certifikimin e prodhuesve dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve softuerike, si dhe detyrimet e rregullat e tjera procedurale për zbatimin e këtij neni”. Siç ju paralajmërova, ju do të na thoni nesër në komision koston e mirëmbajtjes.

Pra, nesër dua të Komisioni i Ekonomisë të dëgjojë nga ju se sa do të ishte sot kostoja për një tatimpagues. Nuk do ta dërgoj ligjin në seancë plenare nëse ju nuk i tregoni komisionit se sa do të jetë kostoja nesër, mirëmbajtja dhe të gjitha. Nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta vëmë koston e ulët, por do ta diskutojmë nesër.

Vullnet, çfarë kishit?

Vullnet Sinaj – Mund të jetë një procedurë e liberalizuar e tregut. Nuk kemi pse ta caktojmë ne koston, por do ta tregojë konkurrenca në treg. Njëri e ka 5, njëri 3, njëri 2. Pse duhet t’jua bëjmë gati?

Arben Ahmetaj – Nuk thashë se do ta caktojmë ne, por dua të di koston. Nëse sot do të ishte në fuqi ligji, sa do ta kishte koston një tatimpagues në Republikën e Shqipërisë për ta zbatuar këtë ligj? Pra, për mirëmbajtjen, për certifikimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si ka kompani të ndryshme?

Ne po kalojmë një ligj të rëndësishëm. Nëse ne jemi imun për koston, nesër mund të konfuzojmë të gjithë terrenin ekonomik. Nëse do t’ia shtyjmë afatet biznesit të vogël për në shtator të vitit 2020 dhe janar të vitit 2021, siç e thashë, unë dua që kur Kryeministri i Shqipërisë të flasë me term ekonomik, të jetë i qartë për kostot. Kjo qartësi duhet të rrjedhë nga ju. Ne si deputetë kemi nevojë të qartësohemi për koston.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, zonja Senida.

Senida Mesi – Në kostifikim , për sa kohë që këtu i referohet në shumë nene, edhe AKSH-it, i cili është autoriteti që bën certifikimin dhe merret me aplikacionet, të jetë edhe një përfaqësues nga AKSH-i bashkë me ju, që të na e shpjegojë nga ana teknike dhe e kostifikimit sa mund të shkojë minimumi dhe maksimumi.

Elton Haxhi – Të vetmen kosto që kemi të sigurt është ajo e AKSH-it, sepse atë e vendosim ne. Kostot e tjera i vendosin ...

Arben Ahmetaj – Më falni, zonja Senida bëri një sugjerim.

Ju lutem, besoj se është edhe në logjikën normale të administratës, që kur të vini nesër, t’i sqaroni deputetët se sa do të jenë kostot në treg. Sa janë sot? Pra, nëse AKSH-i ka një kosto certifikimi X, ju do të thoni se kostoja e certifikimit të firmës elektronike është X lekë, mirëmbajtja mujore ose vjetore është X lekë. Kështu, ne e dimë çfarë kostoje po i ngarkojmë tatimpaguesit dhe do të bëjmë një llogari nëse është kosto e re shtesë apo kosto, e zëvendësueshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo do të ishte edhe më mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Në vazhden e informacionit që duhet të sjellin për kostot e mirëmbajtjes apo te certifikimit, mendoj se është shumë e rëndësishme të vazhdoj ta themi edhe sot atë që u kërkua dje, dhe kërkoj mbështetjen e komisionit që ta kërkojmë njëzëri nga ministria: jo vetëm mirëmbajtja, por edhe pajisjet, sidomos që kërkojmë një shtyrje në kohë të hyrjes në fuqi për biznesin e vogël. Sa është kostoja e pajisjeve?

Arben Ahmetaj – Do të bëhet vlerësim në fund të vitit, që të hyjë biznesi i vogël.

Blerina Gjylameti – Ekzaktë.

Kjo do të thotë: sa është kostoja e kompjuterit? Sa është kostoja e printerit dixhital? Sa është kostoja e pajisjes për firmën dixhitale? Ne duhet të themi: Sa është kostoja sot në treg? Sa do të jetë kostoja nesër kur të liberalizohet? Sa do të jetë kostoja e mirëmbajtjes? Në fund, sa do të jetë ngarkesa, në mënyrë të veçantë për biznesin e vogël? Më pas edhe për të tjerat.

Arben Ahmetaj – I morët shënim pyetjet e zonjës Blerina, sepse do t'i diskutojmë nesër?

Edhe një pyetje për komisionin. Do të doja që nesër t'i tregonit komisionit në narrativë se ku aplikohet ky sistem për biznesin e vogël, aty ku ka definicione të biznesit të vogël? Në cilin vend? Këtë dua ta ndaj me komisionin dhe qytetarët dhe t'u themi bizneseve të vogla: kjo është një normë ose standard, që e përdorin shumë vende, në mënyrë që biznesi i vogël pas datës 31 dhjetor 2020, kur ne të kemi bërë vlerësimin, nëse vlerësimi do të jetë duhet vënë, do ta shtrijmë edhe te biznesi i vogël, por këto i duam nga ju si Ministri e Financave, që ta përdorim edhe ne kur të shkojmë në seancë, sepse do të pyesin edhe grupet përkatëse, qoftë të opozitës, qoftë të maxhorancës, dhe t'i sqarojmë deputetët për pyetjet që mund të kenë kur të mbrojmë ligjin.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 17 i projektligjit. Në pikën 2 për teknikë legislative, sugjeroj të hiqen fjalët e përmendura në pikën 1 të këtij neni.

Ka ndonjë gjë tjetër për nenin 17?

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18 i projektligjit. Sugjerohet riformulimi për saktësim të vlefshmërisë së “kasave fiskale” me “pajisje fiskale”.

Këtu dua qartësim, që sistemi aktual i kasave të vazhdojë të funksionojë specifikisht për biznesin e vogël dhe të përcaktohet edhe ndërfaqësimi me sistemin aktual.

Faleminderit!

Kush është pro?

Blerina Gjylameti – Më falni, do të doja të kishim një sqarim të mëtejshëm. Mënyra e formulimit të jetë se si kasat fiskale ndërthuren me pajisjet fiskale, jo vijimësia nga kasat fiskale në pajisje fiskale, sepse kjo tregon që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo zëvendësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndaj thashë “jo vijimësia”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërthurje që nuk dalin jashtë funksionit, por të gjendet mënyra.

Arben Ahmetaj – Pra, biznesi i vogël ...

Zoti zëvendësministër, uleni dorën!

Pra, këtë e dua për rekorde zyrtare.

Nuk ka ligj që të detyrojë të gjithë fshirjen e kasave dhe nuk ka ligj që të nënkuptojë se kasat do të vazhdojnë. Ligji është taksativ dhe duhet të jetë i shkruar saktë, ku të përmenden qoftë pajisjet fiskale aktuale, edhe pajisjet me *softwar*-e, si dhe detyrimi i integritetit të dy instrumenteve.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Diskutime pa mikrofon)

E thamë.

Kush është pro nenit 18?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shkruhet dhe i referohemi ne nesër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu po e ndërpresim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vijë nesër riformulimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi ligjvënësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Toni.

Elton Haxhi – E para, legjislacioni aktual nuk e ka termin “kasa fiskale”, por “pajisje fiskale”. Kemi ruajtur të njëjtën terminologji, “pajisje fiskale”. Nuk mund ta fusim si ndërfaqe, por e kemi futur te përkufizimet si server të ndërmjetëm, si zgjidhje *softwar*-e të ndërmjetme. Po të doni, e përsërisim.

Arben Ahmetaj – Në emër të komisionit, zoti Toni, të jemi të qartë, dua që shkrimi i ligjit, së pari, të garantojë vazhdimin e sistemit aktual e para, me memoriet fiskale; e dyta, ndërfaqësimi me një fjalë më të mirë dhe më të saktë, që mund ta gjeni ju si detyrim; e treta, jo vetëm te përkufizimi, por edhe në nenin 18. I dua të shkruara qartë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse, doni të shkatërroni memorien fiskale?

Elton Haxhi – Jo, duam memorie të thjeshtë.

Arben Ahmetaj – Ne mendojmë se memoria fiskale duhet të ekzistojë dhe tatimpaguesit që kanë memorie fiskale, të vazhdojnë ta kenë ...

Elton Haxhi – Nuk e ndalojmë memorien fiskale, por nuk është kusht i detyrueshëm të jetë fiskale. Mund të jetë fiskale ose jofiskale.

Arben Ahmetaj – Atëherë, meqë nuk është kusht, do të shkruhet: “mund të mbajnë edhe pajisjen aktuale me memorie fiskale”. Pra, nuk do të jetë kusht të zëvendësohet ...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem!

Anëtarëve do t’ju lutesha të kontribuojnë për këtë.

Pra, biznesi i vogël nuk duhet ta ketë kusht instrumentin e ri *softwar*, por mund të përdorë kasën. Detyrimi për t’u ndërfaqësuar, për t’u futur në sistem nëpërmjet një serveri të ndërmjetëm, siç u referuat ju memories fiskale, meqë ju thoni “mund”, mendoj se është me detyrim ta mbajnë, sepse do të funksionojnë me ato kasa.

Nesër, nga shërbimet e Kuvendit, bashkë me Ministrinë e Financave, dua të kem formatimin e kësaj që ka kërkuar komisioni njëzëri.

Faleminderit!

Takohemi nesër në orën 10:00.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti